



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:106318
Datë: 24.04.2023
Numri i dokumentit: 04210601

Rev.nr.56/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Milena Gjeriq dhe Muhamet Rexha, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. A. nga F., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (tani Telekom i Kosovës), sh.a me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R. B., me objekt kontesti anulim i vendimit dhe kompensimi i diferencës së pagave, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4588/2019, të datës 19.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.04.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4588/2019, të datës 19.10.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.92/19, të datës 26.06.2019, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. A. nga F., kundër të paditurës Posta dhe Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit anulohet aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, nr.01-..., i datës 07.03.2012.

Në pikën III të dispozitivit detyrohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Sh.a Prishtinë, që paditësit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 4.031.4 (katërmijë e tridhjetë e një euro e katër cent), dhe atë në emër të ndryshimit të pagës në mes të gradës 6 dhe 5, shumën prej 77.78 euro për çdo muaj, duke filluar nga muaji shkurt 2012 e deri në muajin shtator 2015, pra shumën prej 3.422.32 euro, kontributet pensionale që duhet të paguhet nga PTK-ja në shumë prej 380.98 euro, si dhe kamatën në shumë prej 228.10 euro, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit së bashku me kamatën 8%, nga dita e parashtrimit të padisë 27.04.2012 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pikën IV të dispozitivit është obliguar e paditura që shumën prej 4.031.4 (katërmijë e tridhjetë e një euro e katër cent), si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 220 euro, t'ia paguaj paditësit në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr.4588/2019, të datës 19.10.2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës Telekom i Kosovës sh.a Prishtinë (ish Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës), ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.92/2019 të datës 26.06.2019, përveç kamatës në të cilën pjesë ndryshohet dhe vendoset: detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 26.06.2019, e deri në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i të paditurës, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të LPK-së dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të pranoj revizionin, të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar ose çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Pala paditëse nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi B. A. nga F. me datë 27.04.2012, në Gjykatën Themelore në Ferizaj ka parashtruar padi, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a,

me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen anulimi i vendimit për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale dhe kompensimin e diferencës së pagave, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë, në mbështetje të provave të administruara si në seancën e shqyrtimit kryesor ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe lidhur me të njëjtën ka vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit, mes tjerash gjykata ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratën nr.01-..., datë 20.10.2011, sipas së cilës kontratë paditësi është caktuar në detyrat e punës Teknik i Elektros në Departamentin Teknik, me pagë mujore në lartësi të gradës 6. E paditura me vendimin nr. 01-... të datës 07.03.2012, paditësit i cakton të ardhura mujore në gradën 5, ashtu që vendimi konsiderohet si pjesë e kontratës së punës, me efekt nga data 01.02.2012. Gjykata ka vlerësuar se vendimi kontestues është në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës, duke marrë parasysh se palët raportin e tyre punëdhënës - punëmarrës e kanë rregulluar me kontratë, në të cilën kanë përcaktuar të drejta dhe detyrime reciproke mes tyre.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktuese, ku palët duhet t'i respektojnë kushtet për lidhjen e kontratës, përfshirë aftësinë punuese, dhe vullnetin e palëve, lëndën e kontratës dhe bazën juridike. Si rregull i përgjithshëm dhe parim i së drejtës është që palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijojnë raportin juridik, respektivisht marrëdhënien juridike dhe me vullnetin e tyre, mund të ndryshojnë një marrëdhënie juridike. Meqë në rastin konkret, kushtet e kontratës janë ndryshuar me vullnetin e shprehur vetëm të njëjës palë, për këtë arsye gjykata vendosi që të anuloj si të kundërligjshëm vendimin për uljen e pagës, duke e detyruar të paditurën edhe në kompensimin e diferencës në pagë për periudhën kohore nga hyrja në fuqi e vendimit të kundërligjshëm e deri në lidhjen e kontratës së vlefshme mes ndërgjyqësve, përkatësisht deri në muajin shtator 2015, në diferencën e pagës neto prej 75.78 € në muaj, e cila është konstatuar në ekspertizën financiare të hartuar më datë 23.04.2019 nga eksperti Y. A. Vendimin lidhur me çështjen kryesore gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 10.1 pika 2.1, 11, 55 të Ligjit për Punë. Vendimi për kamatën është marrë me referim në nenin 382 të LMD-së (2012), ndërsa vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës ka refuzuar të pabazuar ankesën e të paditurës Posta dhe Telekomit të Kosovës PTK- Sh.a, me seli në Prishtinë dhe ka pranuar vlerësimin juridik të gjykatës së

shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, përveç kamatës të cilën pjesë e ka ndryshuar të cekur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vlerësuar aktgjykimin e goditur të gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara në ankesë. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i ekzaminueshëm. Në aktgjykim janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga të cilët është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë. Gjithashtu, gjykata e shkallës së dytë e ka vlerësuar si të pambështetur pretendimin ankimor për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, pasi siç rezulton nga shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë me kujdes i ka çmuar të gjitha provat e propozuara nga ndërgjyqësit, duke konstatuar drejtë se disa fakte për palët në procedurë nuk ishin kontestuese dhe atë se me kontratën e punës Nr.01..., të datës 20.10.2011, paditësit për vendin e punës i është caktuar paga në lartësi të gradës 6, ndërsa sipas aktvendimit nr...., të datës 07.03.2012 (me efekt nga data 01.02.2012), paditësit i është zbritur paga në gradën 5. Nga faktet e rastit ka rezultuar se paditësi është dëmtuar në pagë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës si dhe me vetë kontratën e punës - e cila ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit kontestues, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur ta anuloj si të kundërligjshëm aktvendimin me të cilin paditësit, pa vullnetin e tij dhe pa ndonjë arsye të qëndrueshme i është zbritur paga.

Gjykata e Apelit po ashtu ka vlerësuar se në raport me faktet e rastit gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar ligjin material nga neni 11 dhe 55 i Ligjit të Punës, duke e detyruar të paditurën të paguaj diferencën në pagë për periudhën kohore nga data 01.02.2012 (kur aktvendimi ka hyrë në fuqi) e deri më datë 02.09.2015 kur palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë të re të punës. Meqë lartësia e detyrimit në emër të diferencës në pagë është provuar me ekspertizën financiare, këtë provë e pranoi si të besueshme edhe gjykata e shkallës së dytë, pasi ekspertiza (edhe pse ka përfshirë edhe periudhën kohore pas lidhjes së kontratës së vitit 2015) është mirë e argumentuar sa i përket diferencës së të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës.

Gjykata e Apelit nuk e pranon të bazuar pretendimin ankimor të palës së paditur se paditësit i është ulur paga mujore mbi bazën e vendimit të aksionarit - MZHE (Ministrisë për Zhvillim Ekonomik), për faktin se nga përmbajtja e vendimit të referuar, rezulton se i njëjti ka karakter rekomandues për të paditurën në drejtim të uljes së shpenzimeve në PTK, në raport me të hyrat e përgjithshme. Meqenëse, gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, në gjykatën e shkallës së parë e paditura nuk ka dëshmuar se ka miratuar ndonjë plan për zbatimin e rekomandimeve të

aksionarit MZHE-së, apo që për vendet përkatëse të punës të ketë nxjerrë rregullore për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale, prandaj ky pretendim vlerësohet si i pambështetur dhe pa ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe përkitazi me ankesën e të paditurës në çështjen konkrete juridike.

Gjykata e shkallës së dytë e pranoi ankesën e të paditurës lidhur me normën e kamatës së gjykuar në shkallë prej 8%, e që në kuptim të dispozitës së nenit 277 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), kamata duhet të jetë si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, meqë vendimin kontestues e paditura e ka nxjerrë me datë 07.03.2012, kohë në të cilën ishte në fuqi ligji në fjalë për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Pretendimet e të paditurës të paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 180.1, 180.2, 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta në procedurën gjyqësore të zhvilluar në këtë çështje kanë garantuar objektivitetin e procesit gjyqësor, barazinë e palëve në proces dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të kërkesave ligjore si për procedurën ashtu edhe për të drejtën materiale. Në këtë mënyrë aktgjykimet, ligjshmëria e të cilave kontestohet përmes revizionit, janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje.

Po ashtu nuk janë pranuar pretendimet tjera në revizion për shkelje të dispozitave të nenit 190.2 dhe 191.1 të LPK-së, për faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në gjenden faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë, dhe se gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur për obligim të mbajë seancë gjyqësore në prezencë të palëve lidhur me ankesën e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, kjo pasi që me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: *“Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshinë elementet e përcaktuara sipas neni 11 të këtij ligji”*. Me nenin 11 të këtij ligji përcaktohet se: *“Çfarë duhet të përmbaj kontrata*

e punës”, ndërsa në paragrafin 1 pika 1.8 të këtij neni përcaktohet lartësia e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër. Me nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës”*. Me nenin 5 të kontratës së punës Nr.01.-2880-433/2011 të datës 20.10.2011, është përcaktuar se: *“Të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi të gradës 6, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-së, Nr. 01-1630/05, të datës 28.02.2005, së paku një herë në muaj, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe në raport me zbatimin e të drejtës materiale duke vlerësuar se e paditura ka për detyrim që paditësit ti bëjë kompensimin e diferencës së pagës në shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjyqimit të shkallës së parë, sepse sipas kontratës së punës paga është përcaktuar sipas gradës 6 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit të Punës. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Ministrisë nuk janë precizuar se cilat janë shpenzimet operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajizuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve, duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet e të paditurës janë të pabazuara.

Në këtë rast nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të kryeshefit ekzekutiv. Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta, drejt kanë aplikuar të drejtën materiale përkatësisht nëse i referohemi nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, me të cilën është përcaktuar se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Meqenëse e paditura me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar se ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike edhe kjo gjykatë erdhi në përfundim

se ekziston detyrimi juridik - civil ndaj paditësit për kompensimin e diferencës së pagës nga grada 6 në gradën 5, në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe gjen mbështetje edhe në nenin 262 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Si rezultat i kësaj, meqenëse se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, e paditura ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit, andaj në kuptim të kësaj dispozite ligjore, e paditura është në detyrim ndaj paditësit përkitazi me pagesën e diferencës kontestuese të pagës.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.56/2023, më 20.04.2023

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Zenel Leku